



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

FTESË PËR NEGOCIATË
PËR
AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR SHËRBIM VIDEOGRAFIK NË
KUADËR TË ZGJEDHJEVE TË QEVERISJES VENDORE TË 14 MAJIT 2023.

Në mbështetje, vendimit nr.1195, datë 05.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” dhe vendimit nr. 230 datë.27.12.2022 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do të realizojë “Shërbim videografike” për Zgjedhjet Vendore të 14 majit 2023.

A- OBJEKTI

“Shërbim videografike” për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023.

Periudha e realizimit: Realizimi i shërbimeve do të jetë 5 ditë mnga kërkesat që do të vinë KQZ sipas tematikës së kërkuar përgjatë 12 muajve.

Fondi limit i përcaktuar: fondi limit i procedurës është në vlerën **4,000,000 (katër milion) lekë pa Tvsh.**

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbledhjetë muaj)

Publikimi i ftesës për negociatë: 27 shkurt 2023

Afati përfundimtar për paraqitjen e konfirmimeve nga media e shkruar/agjencia e specializuar është më datë 03 mars 2023 **ora 16:00.**

Konfirmimet për vazhdimin e negociatave: Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës **01 mars 2023, ora 16.00.**

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4
Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Shërbim videografike", kriteret do të jenë si më poshtë.

B- TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi i këtij shërbimi është: Informimi, Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve në të gjithë Shqipërinë jo vetëm në periudhën zgjedhore por gjatë gjithë vitit kalendarik. Nisur nga rekomandimet e organizatave të huaja mbi edukimin e zgjedhësve, KQZ në planin e punës së saj ka planifikuar ndërgjegjësim dhe informin të zgjedhësve në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm në pragë të periudhave zgjedhore me qëllim qasjen me familjare me proceset zgjedhore. Në eridha zgjedhore ky shërbim do tju vi në ndihmë të gjithë zgjedhësve, që të informohen për hapat e procesit zgjedhor, kërkimin e emrit në listat e zgjedhësve, dokumentet që duhen në ditën e zgjedhjeve, mënyrën e plotësimit të fletës së votimit, krimet zgjedhore, identifikimin dhe votimin elektronik, e të tjera, jo vetëm në një zonë të caktuar, por në të gjithë vendin.

Përshkrimi:

Shërbim videografike, në kuadër të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve për proceset zgjedhore gjatë gjithë vitit kalendarik jo vetëm në periudhë zgjedhore.

Shërbime videografike që përfshijnë kompozimin, realizimin dhe prodhimin në post-produksion të videove dhe materialeve filmike me karakter multimedial.

KQZ ka planifikuar implementimin e serive të spotëve multimediale për të garantuar jetëzimin e aktiviteteve të edukimit, informimit dhe promovimit të së drejtës së votës për kategoritë e të rinjve votues për herë të parë, kategorive të nënpërfaqësuar të zgjedhësve, zgjedhësve nga pakicat kombëtare, grave dhe komuniteteve rurale, para dhe pas fushatave zgjedhore.

C- SHËRBIMET QË KËRKOHEN TË REALIZOHEN:

1. Shërbime videografike që përfshijnë kompozimin, realizimin dhe prodhimin në post-produksion të videove dhe materialeve filmike me karakter multimedial.
2. Implementimin e serive të spoteve multimediale për të garantuar jetëzimin e aktiviteteve të edukimit, informimit dhe promovimit të së drejtës së votës për kategoritë e të rinjve votues për herë të parë, kategorive të nënpërfaqësuar të zgjedhësve, zgjedhësve nga pakicat kombëtare, grave dhe komuniteteve rurale, personat me aftësi ndryshe e të tjerë, si dhe hulumtime të thelluara të informacionit publik në dispozicion, para dhe pas fushatave zgjedhore.
3. Realizimin e materialeve filmike autentike të xhiruara me dron, me kamera të specializuara filmike të cilësisë më të lartë, përmbajtje multimediale origjinale ku përfshihen edhe përfitimi i të drejtave të kolonave zanore dhe shërbimet casting për të garantuar realizimin e veprave filmike me të gjitha të drejtat e autorit të garantuara.
4. Shërbimi videografik përfshin edhe të gjitha kostot dhe qeratë potenciale të çdo pajisjeje, teknike apo cdo asistencë tjetër që mund të nevojitet në realizimin e shërbimit videografik.
5. Shërbimi videografik do të duhet të përfshijë realizimin e cdo kompozimi 2d dhe 3d, si edhe përshtatjen finale teknike për transmetim në cdo kanal të medias sociale, televizive dhe radiofonike, në transmetimin digital.

Materialet e përshtatura për transmetim duh

\et të dorëzohen në format VIDEO HD1080, Format MP4 kopje në DVD/USB.

Ç- INFORMACION DHE KËRKESA SPECIFIKE NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Kriteret e pranimit/kualifikimit

1- Kriteret e përgjithshme ligjore:

- A. Ekstrakti i shoqërisë, që është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- B. Nuk është në proces falimentimi (status aktiv).

- C. Vërtetim që nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së.
- D. Deklaratë që nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- E. Deklaratë që ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- F. Deklaratë që kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

2- Kriteret e përgjithshme profesionale:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit për negociatë, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit të parashikuar për këtë shërbim. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:
 - *Për kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
 - *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*
- 3- Ofeta ekonomike: Operatorët do të duhen të paraqesin ofertën ekonomike të detajuar sipas 5 zerave të shërbimit të paraqitur më sipër në vlerën pa tvsh dhe me tvsh.
- 4- Operatorët ekonomik do të paraqesin një projekt ide/ zgjidhje teknike/ propozim për realizimin e shërbime që kërkohen.

D- KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i ofertës ekonomike më të favorshme sipas pikëzimit të mëposhtëm:

- **Kriteret e përgjithshme ligjore:** 10 pikë
- **Kriteret e përgjithshme profesionale:** 20 pikë
- **Oferta financiare** 10 pikë
- **Zgjedhja teknike/propozimin për realizimin e shërbimit (projekt ideja)** 60 pikë

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al